


# MANUAL INSTALIMI



## GPON Modem



**JU LUTEM LEXONI ME KUJDES MANUALIN E INSTALIMIT DHE NDIQNI ME KUJDES HAPAT SI MË POSHTË. KY MANUAL DO JU NDIHMOJË TË INSTALONI SI DUHET DHE TË SHMANGNI PËRDORIMIN E GABUAR TË PAJISJES SUAJ.**

## Kërkesat Bazë

- » Mbani pajisjen e pastër gjatë magazinimit, transportimit dhe instalimit.
- » Ruani pajisjen nga përplasja me objektet e tjera gjatë magazinimit, transportimit dhe instalimit.
- » Instaloni pajisjen në përputhje të plotë me kërkesat e shitësit.
- » Mos e çmontoni pajisjen. Kontaktoni suportin teknik nëse ndodh një difekt në pajisje.
- » Asnjë kompani apo individ nuk duhet të ndryshojë strukturën, sigurinë apo dizajnin e pajisjes pa autorizim.

## Kërkesat e Mjedisit

- » Instaloheni pajisjen në një vend të freskët i cili nuk është i ekspozuar në diell.
- » Mbani pajisjen e pastër.
- » Mbani pajisjen larg ambienteve me lagështi.
- » Mos vendosni asnjë objekt mbi pajisje pasi i nxehti dhe pesha e rëndë mund ta dëmtojnë.
- » Lini një hapësirë prej të paktën 10 cm rreth pajisjes për të shpërndarë nxehtësinë.
- » Mbani pajisjen larg ambienteve që mund të jenë burim flake si ngrohësit elektrik apo qirinjtë.
- » Mbani pajisjen larg nga aparatet elektrike me fusha të forta magnetike apo elektrike, të tilla si furrat me mikrovalë, frigoriferë, dhe telefonat celular.

## Instruksione për Pastrimin

- » Para se të filloni pastrimin e pajisjes fikenit dhe hiqni të gjithë kabujt, duke përfshirë kabullin elektrik, fibrën optike, kabujt e rrjetit.
- » Mos përdorni detergjent të lëngshëm ose spërkatës për të pastruar pajisjen. Përdorni një leckë të butë.



## Instruksiione për përdorimin

- » Përdorni aksesorët të cilët ju janë dorëzuar bashkë me pajisjen apo, që ju janë rekomanduar nga shitësi, si ushqyesi.
- » Voltazhi i ushqyesit të pajisjes duhet të plotesojë kërkesat e voltazhit në hyrje të pajisjes.
- » Kujdesuni që duart tuaja të jenë të thata para se të hiqni apo vendosni kabujt.
- » Fikeni pajisjen dhe hiqeni ushqyesin nga priza para se të hiqni apo vendosni kabujt, duke përfshirë kabullin elektrik, fibrën optike, kabujt e rrjetit.
- » Në ditët me stuhi fikeni pajisjen dhe hiqni të gjithë kabujt duke përfshirë kabullin elektrik, dhe kabujt e rrjetit.
- » Mbani pajisjen në vende pa lagështirë ose në vende ku nuk mund të ketë kontakt me ujin. Nëse ndodh një aksident i tillë fikeni menjëherë pajisjen dhe hiqni të gjithë kabujt duke përfshirë kabullin elektrik, fibrën optike, kabujt e rrjetit. Kontaktoni suportin teknik nëse pajisja nuk punon.
- » Mos i tërhiqni, shtypni, varni apo përthyeri në mënyrë ekstreme kabujt pasi mund të dëmtohen dhe mund të çojnë në mosfunksionimin e duhur të pajisjes.
- » Mos përdorni kabujt të cilët janë të dëmtuar apo të vjetëruar.
- » Mos shikoni në portën optike të pajisjes pa syze mbrojtëse pasi drita infrared mund të dëmtojë sytë tuaj.
- » Në rast të ndonjë anomalie, të tilla si tymi dhe tinguj jo-normale fikeni menjëherë pajisjen dhe hiqni të gjithë kabujt duke përfshirë kabullin elektrik, fibrën optike, kabujt e rrjetit. Kontaktoni suportin teknik nëse pajisja nuk punon.
- » Kujdesuni që mos bien në pajise objekte të huaja metalike nëpërmjet hapsirave boshe që shërbejnë për ajrimin e pajisjes.
- » Mbani pajisjen larg fëmijëve pasi mund të gëlltisnin ndonjë nga aksesorët e saj.


## PJESËT PËRBËRËSE

Hapni kutinë e produktit dhe kontrolloni me kujdes sendet e listuara mëposhtë. Nëse sendet që ndodhen brenda në kuti nuk përputhen me sendet e listuara në tabelë, ju lutem kontaktoni shitësin.

- ❑ **ONT Huawei HG8346M**
- ❑ **Manuali i Instalimit**
- ❑ **Ushqyesi i ONT**




## PANELI PASËM



- 1 Butoni ON/OFF
- 2 Porta e energjisë elektrike
- 3 Porta USB
- 4 Portat POTS
- 5 Hapsira ku kalon FO për tu vendosur në portën Optike
- 6 Porta LAN4 ku do të lidhet STB
- 7 Portat Ethernet LAN1, LAN2, LAN3

## PANELI ANËSOR



No.	Dritat LED	Funksioni
1	Reset	Mbajeni të shtypur për 5 sekonda për ta kthyer konfigurimin e ONT në gjendjen fillestare (mund të përdoret kur ju nuk mund të aksesoni ONT, shembull keni harruar password e logimit). Kujdes: Ky veprim mund të shkaktojë shkëputje të shërbimit, prandaj përpara se të veproni, kontaktoni me suportin teknik të TRING.
2	WLAN	Shtyp butoni WLAN për të aktivizuar ose ç'aktivizuar funksionin WIFI.
3	WPS	Shtyp butoni WPS për të aktivizuar funksionin mbrojtës të WIFI.

## PANELI PËRPARA




Tabela.1 Dritat LED


Dritat LED	Statusi	Përshkrimi
WPS	On	Funksioni WPS është i aktivizuar.
	Pulsuese	Të paktën një terminal WIFI po akseson sistemin.
	Off	Funksioni WPS është i çaktivizuar.
WLAN	On	Funksioni WLAN është i aktivizuar.
	Pulsuese	Janë duke u transmetuar të dhëna.
	Off	Funksioni WLAN është i çaktivizuar.
USB	On	Porta USB është e lidhur dhe po punon në mënyrën "host", por nuk janë duke u transmetuar të dhëna.
	Pulsim i shpejte (Dy herë në sekondë)	Po transmetohen të dhëna.
	Off	Sistemi nuk është i ndezur ose porta USB nuk është e lidhur.
TEL1 - TEL2	On	Shërbimi I telefonisë është I aktivizuar.
	Pulsim i shpejte (Dy herë në sekondë)	Shërbimi i telefonisë është aktivizuar dhe është në gjendjen "off-hook" ose "ringing" (duke rënë zilja).
	Pulsimi i ngadaltë (Një herë në sekondë)	Shërbimi i telefonisë i portës TEL është duke u regjistruar.
	On	Lidhja mes portës TEL dhe serverit të telefonisë nuk është realizuar.
LAN1 - LAN4	On	Lidhja Ethernet është aktivizuar.
	Pulsuese	Nëpërmjet portës Ethernet janë duke u transmetuar të dhëna.
	Off	Lidhja Ethernet nuk është realizuar.
LOS/PON	Shikoni Tablen 2.	
POWER	Jeshile	Terminali GPON është i ndezur.
	Portokalli	Bateria shtese është duke dhënë energji.
	Off	Terminali GPON është i fikur.

Tabela.2 Dritat LED

NR	Statusi		Përshkrimi
	PON	LOS	
1	Off	Off	ONT e juaj është e ç'aktivizuar.
2	Pulsim i shpejtë (Dy herë në sekondë)	Off	ONT po aktivizon lidhjen.
3	On	Off	Lidhja me ONT është aktivizuar.
4	Off	Pulsim i ngadaltë (Një herë në sekondë)	Fuqia optike në hyrje të ONT është më e ulët. Kontaktoni me suportin teknik të TRING.
5	Pulsim i shpejte (Dy herë në sekondë)	Pulsim i shpejte (Dy herë në sekondë)	ONT nuk është e autorizuar nga TRING për të aktivizuar lidhje.


## KABUJT LIDHËS DHE PAJISJET PËRKATËSE

Lidhni pajisjet duke përdorur kabujt specifik bazuar në portat si shpjegohet në figurën më poshtë.



- 1 Kabulli Optik
- 2 Adaptorit i energjisë
- 3 Pajisja USB për ruajtjen e të dhënave
- 4 Telefon
- 5 FAX
- 6 STB dhe Televizori
- 7 Kompiuteri

Vendosni fibrën optike në portën optike të ONT dhe sigurojeni atë duke e vijuar në mbajtësit, si tregohet dhe në figurën më poshtë.



Vijimi i fibrës optike

## VERIFIKIME NË RAST PROBLEMESH

### 1. Asnjë nga dritat nuk ndriçon, në momentin kur ndizni ONT

Kontrolloni lidhjen midis përshtatësit të energjisë dhe ONT. Nëse problemi vazhdon, atëherë mund të jete dëmtuar njera nga pajisjet: ONT, ose ushqyesi. Në këto raste ju duhet të kontaktoni me suportin teknik të TRING.

### 2. Pajisja e ndezur, nuk ka internet

Verifikoni që PC ka marrë adresë IP. ONT i dërgon PC adresë IP të rangut: 192.168.100.64 deri 192.168.100.253.

Bëni ping Default Gateway: 192.168.100.1

#### a) Në rast se përgjigja e ping të gateway është "Request timed out".

Kontrolloni dritat "Ethernet" në pjesën përpara të ONT.

- § Nëse drita që tregon portën ku është lidhur PC, është e ndezur sigurohuni gjithashtu që nuk keni instaluar ndonjë software mbrojtës (firewall). Nëse po, ç'aktivizojeni për momentin deri sa të zgjidhni problemin dhe aktivizojeni sërish.
- § Nëse drita që tregon portën ku është lidhur PC është e fikur, kontrolloni lidhjen e ONT me PC.

#### a) Në rast se përgjigja e ping të gateway është :

**"Reply from 192.168.100.1: bytes=32 time<1ms TTL=255".**

Kontrolloni dritat PON dhe LOS të ONT:

Në rastin kur shërbimi internet është në rregull drita PON qendron e ndezur jeshile statike dhe drita LOS e fikur.

- § Nëse drita PON qendron e ndezur pulsuese kontaktoni suportin teknik.
- § Nëse drita PON qendron e fikur dhe drita LOS qendron e ndezur e kuqe atehere sigurohuni që fibra optike të jetë e mirëvendosur ne portën optike të ONT. Gjithashtu kontrolloni në ambientin e banesës tuaj, për ndonje shkëputje të linjës së montuar nga TRING. Nëse vini re ndonjë këputje, njoftoni suportin teknik të TRING.

### 3. Nuk ka shërbim Telefonie

- § Verifikoni që drita **TEL1** është e ndezur.
- § Nëse drita TEL1 është e ndezur verifikoni qe telefoni juaj është i lidhur ne porten TEL1.
- § Në rast se drita TEL1 është e fikur kontaktoni me suportin teknik të TRING.

## KONTAKT

Kompleksi "Don Bosko",  
Kulla VII, Kati II,  
Tiranë, Albania

**M:** +355 44 800 000

**T:** +355 44 800 000

**F:** +355 44 800 001

**E:** [info@tring.al](mailto:info@tring.al)



tring  
buzëqesh